



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 17.07.2014

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e jashtëzakonshme, të mbajtur më datë 17.07.2014, pas shqyrtimit të propozimit të Nr. 421, të datës 10.07.2014, paraqitur nga Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Instruksionit për rishikimin e buxhetit Nr. 1381, të datës 08.07.2014 nga Ministria e Financave, nenin 27, shkronja (c) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e propozimit Nr. 421 të 10.07.2014, për rishikimin e buxhetit të komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2014.
2. Me rishikim të buxhetit për vitin 2014, lejohen të transferohen mjetet financiare në shumë të përgjithshme prej 150,000.00€, nga kategoria ekonomike e projekteve kapitale, në të njëjtën kategori ekonomike, por në projekte tjera kapitale.
3. Mjetet financiare nga projekti kapital, 'Ndërtimi i shkollës në Nakardë', nga kodi i projektit Nr. 89223, kodi i programit Nr. 92010, fondi burimor 10, në shumë prej 100,000.00€ nga grandit qeveritar, lejohet të transferohen në kodin e projektit Nr. 89200, kodin e programit Nr. 66015, fondi burimor 10, me destinim për projektin kapital të 'asfaltimeve dhe trotuareve në Nakardë'.
4. Mjetet financiare nga projekti kapital, 'Ndërtimi i shkollës në Nakardë', nga kodi i projektit Nr. 89223, kodi i programit Nr. 92010, fondi burimor 21, në shumë prej 50,000.00€ nga të hyrat vetiake, lejohet të transferohen në kodin e projektit Nr. 89206, kodin e programit Nr. 66015, fondi burimor 21, në projektin kapital për 'ndërtimin e kanalizimeve dhe ujësjellësve', me destinim për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimeve në Nakardë.
5. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë, Drejtorisë për Arsim dhe Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi.
6. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FBP, Drejtorisë për Arsim, Drejtorisë për PUKGJ dhe Arkivës.

Kryesues i Kuvendit të Komunës

Mr. Fadil Krasniqi
Për